

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE

Deklaratë për Shtyp

**Mbi nënshkrimin e Marrëveshjes për Linjën e Kredisë me
Bankën Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim**

Sot, më datë 16 Korrik 2014, u nënshkrua ndërmjet Agjencisë së Sigurimit të Depozitave (ASD) dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) marrëveshja për Linjën e Kredisë me vlerë 100 milion Euro. Kjo Linjë është e garantuar plotësisht nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Marrëveshja e Garancisë u nënshkrua në të njëjtën datë ndërmjet Ministrisë së Financave, si përfaqësuese e Qeverisë, dhe BERZH-it.

Skema e sigurimit të depozitave funksionon në Shqipëri që prej vitit 2002. Misioni i saj kryesor është mbrojtja e depozituesve individë duke siguruar depozitat e tyre bazuar në Ligjin “Për sigurimin e depozitave”. Një skemë efikase e sigurimit të depozitave është e një rëndësie parësore sepse përmes rritjes së besimit të depozituesve në sistemin financiar kontribuon në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit.

Linja e Kredisë, në formën e një kredie gatishmërie, do të shërbejë për të rritur efektshmërinë e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave në përmbushjen e detyrimit të saj ligjor, mbrojtjen dhe garantimin e depozitave të individëve. Linja e Kredisë është një instrument gjerësisht i përdorur në fushën e sigurimit të depozitave. Kjo Linjë i vë në dispozicion institucioneve të sigurimit të depozitave, me kërkesën e tyre dhe nëse është e nevojshme, fonde që do të garantonin përmbushjen me sukses dhe efikasitet të qëllimit dhe misionit për të cilat këto institucione janë krijuar.

Si një mekanizëm më shumë që i shtohet elementëve të sigurisë të skemës së sigurimit të depozitave në Shqipëri, Linja e Kredisë rrit nivelin e mbrojtjes së depozituesve duke përmirësuar ndjeshëm nivelin e mbulimit si në nivel depozitash të siguruara ashtu edhe në nivel institucionesh financiare që janë pjesë e skemës së sigurimit.

Me rastin e kësaj ceremonie, Drejtori i Përgjithshëm i ASD, Z. Toni Gogu, u shpreh “Ne e mirëpresim këtë marrëveshje me BERZH-in, si një tregues i mbështetjes dhe besimit që partnerët e rëndësishëm strategjikë kanë në sistemin financiar të vendit dhe Agjencinë e Sigurimit të Depozitave. Jemi të bindur që ky instrument kontribuon pozitivisht në rritjen e mëtejshme të besimit të qytetarëve në sistemin financiar të vendit duke ofruar më shumë mundësi për institucionet financiare në vend. Sigurimi i kësaj linje kredie e forcon akoma më shumë skemën e sigurimit të depozitave në Republikën e Shqipërisë duke plotësuar standartet ndërkombëtare në fushën e sigurimit të depozitave”.

Në ceremoninë e organizuar me këtë rast morën pjesë Zv.Presidenti i BERZH, Z. Phil Bennett, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Z. Ardian Fullani, Ministri i Financave, Z. Shkëlqim Cani dhe zyrtarë të tjerë të institucioneve palë nënshkruese të Marrëveshjes.
